



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.546/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, (e vendosur në objektin e Degës së kësaj Gjykate në Vushtrri), si gjykatë kontestimore e përberë nga gjyqtari individual Naim Mehulli, në çështjen juridike të paditësit: nga Mitrovica te cilin e përfaqëson kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës te cilën e përfaqëson Faik Gurguri, pas mbajtjes së seancës kryesore në prezencën e të autorizuarit të paditësit: 01.12.2016, me datën 08.12.2016 bie këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses në tërësi si e BAZUAR dhe
- II. **VËRTETOHET** se paditësi: nga Mitrovica është shfrytëzues i paluajtshmërisë në sipërfaqe prej 11 m² pjesë e ngastrës kadastrale, ZK në Mitrovicë.
- III. **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Mitrovicës që të drejtën e specifikuar në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi t'ia njoh paditësit si dhe të njëjtit t'ia lejojë regjistrimin e kësaj të drejte në regjistrat kadastral, në të kundërtën ky aktgjykim do t'i shërbej të njëjtit si bazë për regjistrim në regjistrat përkatës kadastral.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me anë të padisë dhe ka pohuar se paditësi gjate vitit 2010 ka blerë paluajtshmerin ne bazë te kontratës se shitblerjes, ndërsa pas blerjes se saj, paditësi ka vërejtur qe nj epjes e saj evidentohet ne emër te te paditurës, paditësi këtë paluajtshmeri e ka blerë si lokal afarist nga shitësi Remo Compani, kurse Remo Compani këtë paluajtshmeri e ka marr për bashkëndërtim nga ish pronari

Në fjalë përfundimtare i autorizuari i paditësi deklaroi se mbetem ne tersi pran padis dhe kërkesëpadisë se parashtuar, me provat e administruara u dëshmuar qartë se paditësi lokalit afarist e ka blerë ne gjendjen ne te cilën është sot, se lokali afarist është i ndërtuar ne pjesën e palujtshmeris lëndore mbi parcelën kadastrale sipërfaqe 11 m², se paraardhësit e paditësit ish pronaret e kësaj palujtshmerie gjithnjë e kanë shfrytëzuar dhe e kanë pas ne pronësi faktike palujtshmerin lëndore, po ashtu është dëshmuar se ish pronaret e kësaj prone me mirëbesim e kanë mbajtur këtë palujtshmeri dhe se askush asnjëherë nuk i ka penguar ne shfrytëzim, i propozoi gjykatës qe ta aprovoi padinë dhe kërkesës padinë e precizuar dhe ta vërtetoi se paditësi është pronar ose shfrytëzues i përhershëm i palujtshmeris prej 11 m² si pjesë e parcelës kadastrale me numër Shpenzimet e procedurës nuk i kërkoi.

Përfaqësuesi i të paditurës gjate shqyrtimit gjyqësor deklaroi se duke pasur parasysh karakteristikat e rastit kontestues për palujtshmerin, konsideroj se trajtimi dhe shqyrtimi gjyqësor duhet bere duke pasur parasysh pozicionin e palujtshmeris ne raport me strukturën urbanistike dhe pozitën ndërtimore te kësaj palujtshmerie ne kuptim te shtrirjes dhe kufizimit te saj e krejt këtë konform natyrës se regjimit te palujtshmeris, me pritje qe vendimi te jete epilog i rezultatit te provave.

Në seancë kryesore gjykata dëgjoi dëshmitarët: dhe
qe përndryshe janë ish pronaret e parcelës ku gjendet lokali afarist i paditësit.

Me qëllim të vërtetimit sa më të plotë të gjendjes faktike gjykata administroi këto prova: kontrata e shitblerjes e lokalit afarist dt.14.04.2010, ekspertiza ekspertiti te gjeodezisë se bashku me skicën e ternit dhe kopien e planit, dt.11.08.2016, certifikata e pronësisë P-aktvendimi mbi trashëgimi dt.12.10.2015.

Provat e administruara gjykata i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku konform dispozitave ligjore, dhe pas kësaj erdhi në këto përfundime:

Për gjykatën nuk është kontestuese se babai i paditësit i ndjeri ka blerë lokalit afarist me dt.14.04.2010 dhe se për këtë lokal është shpallur trashëgimtar paditësi ne bazë te aktvendimi mbi trashëgimi dt.12.10.2015.

Nuk është kontestuese se paditësi pjesën e ngastrës kontestuese e ka në posedim, pasi këtë fakt gjykata e vërtetoi në momentin e daljes në teren, e po ashtu ky fakt u vërtetua edhe nga ekspertiza gjeodete.

Nuk është kontestuese se lokali afarist, përkatësisht 11 m² evidentohen ne emër te te paditurës Komuna e Mitrovicës, kjo vërtetohet ne bazë te ekspertizës gjeodete.

Sa i përket çështjes së shitblerjes dhe periudhës së mbajtjes, e po ashtu edhe mirëbesimit në mbajtje, në mungesë të provave tjera për të

dëshmuar këtë fakt gjykata u bazua në deklarinimin e dëshmitarëve, të cilët deklaratat e tyre i dhanë nën betim.

Dëshmitari [] deklaroi se toka në të cilin është ndërtuar e gjithë ndërtesa se bashku me lokalin të cilin e posedon paditësi ka qene në emër të gjyshit tim [], pas vdekjes se gjyshit e gjithë kjo trashëgimi ka kaluar në emër të agjes tim [], ku në pjesën kontestuese djali i agjes tim ka ndërtuar nja lokal afarist në vitin 2000 ndërsa ky lokal ka ekzistuar deri në vitin 2008, ndërsa në vitin 2008 e gjithë familja token në të cilën ka qen i ndërtuar edhe lokali i djalit të agjes tim me kompensim ja kemi shitur kompanisë "Remo Com", prona jon ka qen e kufizuar me murin e një furre ku në e kemi shfrytëzuar deri të muri i kësaj furre.

Dëshmitari [] deklaroi se në mes të të pronës ton dhe pjesës me të cilin kufizohet nuk ka pasur kurrfarë hapësirë dhe se muret kanë qen të ngjitura mes veti, unë asnjëherë nuk e kam ditur se një pjesë e pasurisë ton evidentohet në emër të Komunës, unë e kam pas një lokal nga viti 2000 deri në vitin 2008 dhe se në vitin 2008 kemi lidhur një marrëveshje me kompaninë " [] " ku është rrënuar objekti jon dhe është ndërtuar një ndërtesë, dëshmitari deklaron se paditësi ka blerë një lokal afarist nga [] pikërisht në hapësirën në të cilën e kam pasur unë lokalin tim.

Sa i përket të drejtës së shfrytëzimit në sipërfaqe 11 m2 pjesë e ngastrës kadastrale [], paditësi këtë të drejtë e ka fituar në bazë të Ligjit për Tokën Ndërtimore neni 11 dhe Ligjit mbi Marrëdhëniet pronësore juridike neni 12 i cili në mënyrë të qartë specifikon se pronari i ndërtesës ka të drejtën e shfrytëzimit të tokës në të cilën është ngritur ndërtesa dhe të tokës që shërben për përdorimin e rregullt të kësaj ndërtese derisa ajo të ekzistojë.


Gjykata e aplikoi Ligjin e Vjetër të pronësisë pasi baza juridike është krijuar në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi, krejt kjo konform nenit 282 të Ligjit për Pronësinë dhe Të Drejtat Tjera Sendore.

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 450 të LPK-së, meqenëse asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk i kërkuan shpenzimet procedurale.

Aktgjykimi u bazua në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.546/2015 Datë: 08.12.2016

GJYQTARI
Naim Mehulli



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej 15 dite nga data e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.